

STATUT I SHOQERISE
"HK Hospitality & Management " shpk.

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 27/01/2025 ne:

1. **Z. Alfred Sadikaj** i biri i Petref dhe Qerime , shtetas Shqiptar, lindur me 13/07/1968, ne Fier dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjofimit me nr 033951650 dhe nr Personal G80713161W,

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, vendosem te miratojme kete Statut si vijon:

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji 9901/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", i n dryshuar;
- "Statuti" eshte ky Statut i Shoqerise;

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 27/01/2025 , ne, themeluesit e mesiperm, themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar **"HK Hospitality & Management " shpk.**

Neni 2
Objekti

Shoqeria dote kryeje aktivitetin e meposhtem: *Veprimtarine ekonomike ne fushe e turizmit, nepermjet ngritjes, operimit dhe administrimit te strukturave turistike pritesë (akomoduese) dhe te gjitha sherbimet direkt apo indirekt te lidhura me to, si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar. Hapjen dhe menaxhimin e bareve dhe restoranteve brenda strukturave turistike pritesë (akomoduese) dhe te gjitha sherbimet direkt apo indirekt te lidhura me to, si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar. Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje çdo lloj veprimtarim apo trasaksion tjeter qe lidhet me pasuri te luajshme e te paluajshme, me kryerjen e veprime tregtare, industrial, bankare dhe/ose financiare te çfaredo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme per arritjen dhe ose plotesimin e objektivit te Shoqerise, qe nuk ndryshon aktivitetin paresor te Shoqerise dhe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi.*



Neni3
Kohczgjtja

Kohczgjtja e shoqerise do te jete e **pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.**

Neni4
Selia

Selia ndodhet ne : Durres, Rezidenca New Born , Hamallaj, njesi me sip 8m brenda ne ambjentet e H&K @ Vala Mar Residences
Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte ALL 100.000 (njqind mije leke). Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tij te meposhtme:

1. Ortaku themelues Alfred Sadikaj : Zoterues i **1 (nje) kuote** me vlere te pergjithshme ALL 100.000 qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut te vetem eshte ne para dhe dote shlyhet prej tij menjehere me themelimin e shoqerise.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e njc eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakcve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakëve dhe te shoqerite kontrolluese dhe/ose te grupit te caktuara me vendimin e Asamblese. Pjeset e kapitalit mund te kalohen te te tretet vetem me miratimin e Asamblese se Pergjithshme, qe jepet nepermjet nje vendimi te mare me unanimitet. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.



KREUIII
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE
Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per 9eshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- 9) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "9" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) shpemdardjen e fitimeve vjetore;
- j) 9eshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme , ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person e trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme . Autorizimi mund te jeet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme , e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njeitin rend.



Neni 9

Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve dote thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaku.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi dote konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 7-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaku per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projektvendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 7 (shtate) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per cdo ceshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Ortaku mund te marrin pjese ne mbledhjet e asamblese se pergjithshme nepermjet mjeteve te ndryshme te komunikimit, perfshire mjetet e komunikimit elektronik, qe garantojne identifikimin e ortakeve. Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to: a) transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale; b) komunikimin e ndersjelle ne kohe reale, i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendndodhje tjeter; c) mekanizma, qe mundesojne procesin e votimit, perpara apo gjate mbajtjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme, pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje. Perdorimi i mjeteve elektronike, per t'u mundesuar ortakeve te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, behet me kushtin qe te merren masat teknike te nevojshme per te garantuar identifikimin e ortakeve dhe sigurine e komunikimeve elektronike, deri ne ate mase qe ky perdorim te jete proporcional me arritjen e ketyre qellimeve.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese mete njeitin rend dite.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 80 (tetedhete) perqind te kuotave.



Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligji. 'Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare', ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shpemdarrjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 **Perjashtimi nga e drejta e votes**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per: vleresimin e veprimtarise se tij; shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij; ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria; dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 **Administrimi**

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet mete drejte riprteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje mandat 5 (pese) vje9ar emerimi:

Znj. Erida Kadëna e bija e Xhorxh dhe Antoneta , shtetas Shqiptar, lindur me 26.06.1989 ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, mbajtes i letemjofitimit me nr Personal I95626090I. nr. kontakti: +355695523636 *pa kufizime ne kompetencat e administrimit.*

Neni 14 **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:



- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zhatuar politikat tregtare, te vendosura nga asamhleja e pergjithshrne;
- h) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mhaajtjen e sakte e te regullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- 9) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mharevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posa9me me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratorejtjane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshrne, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere mete larte se 5 per qind te asetete te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te beje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetete te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshrne emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asamhleja e pergjithshrne mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te parniratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perhalluar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te ve9ante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- h) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresojte me pergjegjesi 9eshtjet, per te cilat merret vendim;
- 9) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim a mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshrne me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit te vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet , qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara . Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator , ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Ne menyre te vecçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e meposhtme: u kthen ortakeve kontributet; u paguan ortakeve interesa apo dividende; u shpëmdan aktivet shoqerise; lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet; jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 16 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V **Prishja - Riorganizimi i Shoqerise**

Neni 18 **Prishja dhe likuidimi**

Shpëmdarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe: kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; me vendim te Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave te falimentimit; ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; me vendim te gjykates



Ne kete rast Ortaku merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise , duke caktuar 1 apo disa likuidator dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e proceduarve te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimenti.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaku.

Nese Ortaku nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, do person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nenshkrua nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU THEMELUES TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "HK Hospitality & Management " shpk.

Alfred Sadikaj

